



UNIVERSITETI PUBLIK “KADRI ZEKA” UNIVERSITY

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjiilan Republika e
Kosovës www.uni-gjilan.net
tel: 0280390112

RAPORT VETËVLERËSIMI – STAFI AKADEMIK

Zyra për Zhvillim Akademik dhe Cilësi

Fitore Malaj-Abdyli

Tabela e Përmbajtjes

Hyrje.....	3
2. Metodologjia e hulumtimit.....	3
2.1 Qëllimi i Hulumtimit.....	3
2. Metodatat e hulumtimit	3
3.Rezultatet e Hulumtimit.....	3
3.1 Informata për rrjedhën e hulumtimit	3
4. Përfundime dhe Rekomandime	6

Hyrje

Këshilli për Mbikëqyrje, Cilësi dhe Vlerësim i Universitetit “Kadri Zeka“ ne Gjilan, ka vendosur që të bëhet një pyetësor ku stafi akademik ka vetëvlerësuar vetën, pyetësori është hartuar nga ZZhAC më pas është vendosur në platformën SMU, ku stafi akademik posa të kycet në sistem, sistemi automatikisht lajmëron të njejtin që është shtuar një pyetësor prej ZzhAC dhe që duhet ta plotësojnë atë.

Ky pyetësor përmbledhës shërben për të lejuar anëtarët e stafit të reflektojnë mbi punën e tyre, performancën dhe kontributet në kontekstin e detyrave dhe rolit të tyre në UKZ.

Metodologjia e hulumtimit

2.1 Qëllimi i Hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi ka të bëjë me identifikimin e problematikave të mundshme gjatë përvojës së stafit akademik në UKZ.

Nga ky hulumtim kemi arritur të nxjerrim vlera të cilat përcakojnë kushtet e punës dhe efikasitetin e proceseve në Universitetin "Kadri Zeka", duke treguar pikat e forta dhe ato që mund të përmirësohen për të avancuar në të ardhmen.

Rekomandimet e dala nga ky vlerësim do t’u shërbejnë Universitetit për të reflektuar mbi gjetjet e hulumtimit.

2. Metodatat e hulumtimit

Hulumtimi u realizua kryesisht përmes metodës kuantitative dhe instrumenteve që janë në funksion të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave.

Në kuadër të kësaj kemi plasuar pyetësorin ne platformën SMU, në momentin që studenti vendos që ta bëjë c’regjistrimin, I detyrueshëm është pyetësorin që duhet ta plotësojnë.

3.Rezultatet e Hulumtimit

3.1 Informata për rrjedhën e hulumtimit

Në kuadër të punëve të Zyrës për Zhvillim Akademik dhe Cilësi (ZZHA) është paraparë që përveç vlerësimit të rregullt të Stafit Akademik, aga ana e studentëve të bëhet edhe vlerësimi Stafit Administrativ, kështu që në bashkëpunim me Menaxhmentin e Lartë të UKZ-së si dhe Këshillin për Mbikëqyre të Cilësisë dhe Vlerësimit (KMCV) kemi hartuar pyetësorin sipas Shkallës së Likertit, ku studenti për secilin konstatim është dashur të rrumbullaksojë 1,2,3,4 ose 5 (5=pajtohem plotësisht; 4=pajtohem; 3=nuk e di; 2=nuk pajtohem; 1=aspask nuk pajtohem).

POHIMET		Vlera Mesatare
1	Unë jam i/e kënaqur me kushtet e punës të ofruara nga Universiteti	4.06
2	Unë gjejë mbështetje të menaxhmenti për çdo vështirësi dhe sfidë eventuale	4.25
3	Ngarkesa ime e punës është lehtë e menaxhueshme	4.58
4	Unë jam në dijeni për misionin, vizionin dhe qëllimet strategjike të Universitetit	4.83
5	Unë marrë pjesë në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse të Universitetit	4.06
6	Unë jam i/e lirë të shpreh idetë e mija dhe propozimet të menaxhmenti i UKZ-së	4.29
7	Hapësira e Universitetit plotëson të gjitha kushtet e nevojshme për realizimin e mësimit efektiv	3.64
8	Hapësira është e furnizuar me pajisje adekuate (projektor, tabelë, banka, karrige, etj)	4
9	Stafi akademik ka qasje të lehtë në shërbimet teknike aty kur kërkohet	4.36
10	Unë arrijë që të prezantoj në mënyrë të saktë qëllimin dhe objektivat e planprogramit	4.80
11	Unë menaxhoj me lehtësi provimet dhe vlerësimet e studentëve	4.90
12	Unë përdor metodologji bashkëkohore të mësimdhënies	4.87
13	Numri i studentëve në sallë është i përshtatshëm për realizimin e rocesit mësimor	4.66
14	Unë ndjehem i/e motivuar për punën time si mësimdhënës në UKZ	4.48
15	Unë ndjehem i integruar brenda Universitetit	4.41
16	UKZ organizon mjaftueshëm konferenca shkencore për stafin akademik	3.87
17	UKZ organizon mjaftueshëm aktivitete të cilat kanë synim zhvillimin e stafit akademik	3.80
18	Unë jam i/e kënaqur me mundësitë e ofruara nga UKZ, për zhvillimin tim personal	4.06

19	Komunikimi me administratën është efektiv	4.63
20	Sjellja e zyrtarëve administrativ është korrekte dhe profesionale	4.6
21	Çdo kërkesë e imja përmbushet në kohë të shpejtë nga shërbimi administrativ	4.5
22	Administrata është gjithmonë në dispozicion për sqarime shtesë dhe asistencë	4.56
23	Unë informohem me kohë nga administrata për çdo ndryshim të orarit të ligjëratave, provimeve apo rocesit mësimor	4.67
	Mesatarja e Përgjithshme	4.39

Tabela 1. Rezultatet e vetëvlerësimit të stafit akademik

Këto pohime janë një vlerësim i stafit akademik për disa aspekte të përvojës së tyre në Universitetin “Kadri Zeka”. Vlerësimet variojnë nga 1 (jo i/e kënaqur) deri në 5 (shumë i/e kënaqur), dhe rezultati përfundimtar është një mesatare e përgjithshme prej 4.39, e cila tregon një nivel të lartë të kënaqësisë së përgjithshme.

Disa pika thelbësore që dalin nga vlerësimet: Misioni, vizioni dhe qëllimet strategjike të Universitetit njihen dhe vlerësohen si shumë të qarta (4.83). Menaxhimi dhe mbështetja për sfidat dhe vështirësitë përfshihen në vlerësim (4.25), ndërsa hapësira për realizimin e mësimin efektiv ka vlerësim më të ulët (3.64).

Në përgjithësi, përdorimi i metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies, menaxhimi i provimeve dhe vlerësimeve, si dhe prezantimi i qëllimeve dhe objektivave të planprogramit, marrin vlerësime të larta.

Ka vlerësime të mira për komunikimin efektiv me administratën dhe për disponueshmërinë e tyre për të ofruar asistencë dhe sqarime shtesë.

Gjithashtu, disponimi i administratës për të informuar për ndryshimet në orar apo proceset mësimore vlerësohet pozitivisht (4.67).

Për shumicën e pohimeve, ka një nivel të konsiderueshëm të kënaqësisë dhe vlerësimit pozitiv nga stafi akademik në shumicën e kritereve të vlerësimit.

4. Përfundime dhe Rekomandime

Pas vlerësimit të informacionit, mesatarja e përgjithshme e shprehur nga pjesëmarrësit tregon një vlerësim pozitiv të kushteve të punës dhe infrastrukturës në Universitetin "Kadri Zeka" (4.39). Niveli i përgjithshëm i kënaqësisë është në një nivel të lartë, sidomos për misionin, vizionin dhe qëllimet strategjike të institucionit. Kjo tregon ndërgjegjësim dhe lidhje të mirë mes punonjësve dhe objektivave strategjike të universitetit. Në përgjithësi, ky vlerësim reflekton një ambient pune të motivuar dhe të integruar për punonjësit.

Rekomandimet që ne mund të i japim janë:

Rritja e numrit të konferencave shkencore dhe aktiviteteve që synojnë zhvillimin e stafit akademik, për të përmirësuar njësitë e vlerësimit në këtë drejtim.

Mundësia për investime shtesë në hapësirën fizike dhe pajisjet për të përmirësuar efikasitetin dhe mësimin efektiv.

Përmirësimi i komunikimit dhe shërbimeve administrative, duke përqendruar vëmendjen në bashkëpunimin e lirë dhe efikasitetin e përgjithshëm për të plotësuar kërkesat e personelit dhe studentëve.

Ky vlerësim ofron një bazë të qëndrueshme për të përmirësuar aspektet që mund të jenë në nevojë të ndryshimit, duke përdorur forcën e vlerësimit për të rritur performancën dhe kushtet e përgjithshme të punës në universitet.